



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 26, DATË 15.04.2020

PËR  
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “MARIUXHO” SH.P.K.,  
AUTORIZUAR PËR PËRSËRITJEN E SHËRBIMIT TË PROGRAMIT  
AUDIOVIZIV TË TË TRETËVE MBËSHTETUR NË RRJETIN KABLLOR “TV  
KABLLOR BULQIZA”, PËR ZVOGËLIMIN E ZONËS SË OFRIMIT TË  
SHËRBIMIT

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

|         |            |                 |
|---------|------------|-----------------|
| Gentian | Sala       | Kryetar         |
| Sami    | Nezaj      | Zëvendëskryetar |
| Agron   | Gjekmarkaj | Anëtar          |
| Gledis  | Gjipali    | Anëtar          |
| Suela   | Musta      | Anëtar          |

pasi mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: Shoqëria “Mariuxho” sh.p.k.

Objekt: Shqyrtimi i kërkesës së shoqërisë “Mariuxho” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “TV kabllor Bulqiza”, për zvogëlimin e zonës së ofrimit të shërbimit duke hequr nga zona e ofrimit të shërbimit “*Njësinë administrative Tomin*”.

Baza Ligjore: Neni 19, pika 16, neni 68, pika “b” të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 12, pika 1/a i rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017.

VËREN

Këshilli Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT), me vendimin nr. 295, datë 22.12.2004 ka licencuar shoqërinë “Mariuxho” sh.p.k., për të ofruar shërbim televiziv kabllor për subjektin “Tv kabllor Bulqiza”, me zonë ofrimi shërbimi qytetin Bulqizë. Pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë së licencës/autorizimit (sipas ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.) KKRT/AMA me vendimet nr. 96, datë 28.03.2011 dhe nr. 50, datë 19.03.2018 ka rinovuar autorizimin e subjektit për një afat

5 vjeçar, dhe ka zgjeruar zonën e ofrimit të shërbimit në Njësitë Administrative Bulqizë, Fushe-Bulqizë, Maqellarë, Zereqan, Tomën dhe Kastriot.

Shoqëria "Mariuxho" sh.p.k., përmes adresës elektronike të autoritetit, në datën 30 mars 2020, ka kërkuar të heqë dorë, nga ofrimi i shërbimit të përsëritjes në rrjet kabllor, në njërin nga njësitë administrative ku ushtron aktivitet.

Konkretisht, subjekti ka parashtruar se *kërkon të heqë dorë nga shërbimi në njësinë vendor Tomën. Nga data 01/01/2020, nuk kryejmë asnjë shërbim në këtë zonë.*

Duke mbajtur parasysh situatën e krijuar për shkak të përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, vlerësojmë së kërkesa e depozituar në formë elektronike, është në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative. Në nenin 59, pika 6 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcaktohet se: *"Kërkesa me shkrim mund të dërgohet edhe me postë të porositur, mjete elektronike ose faks, drejtpërdrejt në adresën përkatëse zyrtare të organit kompetent, të cilit i drejtohet ose në kutinë postare të organit publik. ..."*

Neni 68 i ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, parashikon rastet e pavlefshmërisë së licencës/autorizimit. Në gërmën "b" të këtij neni përcaktohet se autorizimi bëhet i pavlefshëm kur: *".. i licencuari ose i autorizuari njofton me shkrim AMA-n për mbylljen e aktivitetit;...;*

Po ashtu, neni 12, pika 1 i rregullores "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve", miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017, përcakton se aplikuesi i cili kërkon të zvogëlojë zonën e ofrimit të shërbimit për përsëritjen e programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve, duhet të paraqesë pranë AMA-s, kërkesë për zvogëlimin e zonës së shërbimit për përsëritjen e programit audio dhe/ose audioviziv të të tretëve.

Nga verifikimi i faqes zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit, në datën 02.04.2020, rezulton se shoqëria "Mariuxho" sh.p.k., është regjistruar si i tillë në datën 01.01.2005. NIPT-i i subjektit është K76716402J. Objekt i veprimtarisë së këtij subjekti është: *"Media Elektronike. Televizion kabllor, lokal. Ofrim i Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike."* Zyra qendrore e shoqërisë është në *Diber Bulqize BULQIZE Bulqize, Lagja Gjeologu, Pallati i Kultures Bulqize*. Ortak i vetëm i shoqërisë është Edmond Isaku me 100% të kuotave. Administrator i shoqërisë Edmond Isaku. Emri Tregtar: "Tv Kabllor Bulqiza". Statusi i subjektit: Aktiv.

Nga verifikimi i kryer rezulton se subjekti është debitor ndaj AMA-s në masën 966,000 lekë. Pa zonën e ofrimit të shërbimit të subjektit në "Njësinë administrative Tomën", detyrimi për pagesë vjetore për autorizim shkon në masën 830,639 lekë.

Nga inspektimi i kryer nga inspektorët e AMA –s rezulton se subjekti nuk ka ushtruar aktivitet audioviziv në këtë zonë, prej datës 08.01.2020.

Në këto kushte, AMA arrin në përfundimin se kërkesa e subjektit është e mbështetur në ligj,

## PËR KËTO ARSYE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në bazë të nenit 19, pika 16, nenit 68, pika "b" të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe rregullores "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve", miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017,

### V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës së shoqërisë "Mariuxho" sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor "TV kabllor Bulqiza", për reduktimin e zonës së ofrimit të subjektit duke hequr nga zona e ofrimit "Njësinë administrative Tomin".
2. Rillogaritjen e detyrimeve financiare, pagesë vjetore për autorizim.
3. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim i shtrin efektet prej datës 08.01.2020.

|                         |                |                   |
|-------------------------|----------------|-------------------|
| <b>Kryetar:</b>         | <b>Gentian</b> | <b>SALA</b>       |
| <b>Zëvendëskryetar:</b> | <b>Sami</b>    | <b>NEZAJ</b>      |
| <b>Anëtarë:</b>         | <b>Agron</b>   | <b>GJEKMARKAJ</b> |
|                         | <b>Gledis</b>  | <b>GJIPALI</b>    |
|                         | <b>Suela</b>   | <b>MUSTA</b>      |